

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga shoqëria **KER TOKI PAUER SHA**, me seli dhe adresë në qytetin e Sofjes, bul. „Car Osvoboditel“ nr. 14, Bullgari, e dorëzuar përmes avokatit Mr. Nikolla Lazarov, nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 14.02.2024, solli

### **AKTVENDIM**

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin shoqëria **KER TOKI PAUER SHA**, me seli dhe adresë në qytetin e Sofjes, bul. „Car Osvoboditel“ nr. 14, Bullgari, do të fitojë kontrollin mbi **RENJUVABAL ENERXHI SUPLAJ DOO Shkup**, me seli në Bul. Sveti Kliment nr. 30, **Republika e Maqedonisë së Veriut**, nëpërmjet blerjes së një aksioni, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 04.01.2024, e plotësuar më 23.01.2024, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni), është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga **KER TOKI PAUER SHA**, me seli dhe adresë në qytetin e Sofjes, bul. „Car Osvoboditel“ nr. 14, Bullgari, me të cilin shoqëria **KER TOKI PAUER SHA** do të fitojë kontrollin mbi **RENJUVABAL ENERXHI SUPLAJ DOO Shkup**, me seli në Bul. Sveti Kliment nr. 30, **Republika e Maqedonisë së Veriut**, nëpërmjet blerjes së një aksioni.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**KER TOKI PAUER SHA** ofron një gamë të gjerë shërbimesh me cilësi të lartë në fushën e blerjes, shitjes dhe shpërndarjes së pajisjeve të përdorura në ndërtimin dhe funksionimin e termocentraleve fotovoltaike, si dhe aplikacione dhe objekte të tjera të bazuara në energjinë elektrike të prodhuar nga energjia diellore, blerja, ndërtimi, funksionimi dhe menaxhimi i termocentraleve fotovoltaike/solare/elektrike, zgjidhje që lidhen me efikasitetin e energjisë, integrimin e sistemit dhe zhvillimin e softuerit, zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve të internetit dhe teknologjive të informacionit, mbështetja e sistemeve kompjuterike, konsulenca, aktiviteti ndërmjetësues si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar që nuk ndalohet nga ligjet e Republikës së Bullgarisë dhe për të cilin nuk kërkohet leje (licencë) paraprake, dhe në rast se kërkohet leje për ndonjë nga aktivitetet e mësipërme, ajo do të kryhet pas marrjes së saj.

**Para përqendrimit Shoqëria për Tregti dhe Shërbime CENTRAL INVEST SHPK Shkup**, me seli në bul. Sveti Kliment Ohridski nr. 30, Shkup – Qendër dhe **KER TOKI PAUER AD** janë pronarë dhe ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi **Shoqërinë për Tregti dhe Furnizim me Energji Elektrike RENJUVABAL ENERXHI SUPLAJ SHPK Shkup**, e cila përfaqëson një shoqëri maqedonase me përgjegjësi të kufizuar.

**KER TOKI PAUER SHA**, përveç pjesës në **RENJUVABAL ENERXHI SUPLAJ SHPK Shkup**, nuk ka ndërmarrje-bijë, filiale apo përfaqësi të tjera të vendosura në Maqedoninë e Veriut.

Veprimtaria e Shoqërisë për tregti dhe furnizim me energji elektrike **RENJUVABAL ENERXHI SUPLAJ SHPK Shkup** paraqet tregti me energji elektrike.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

## **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**KRYETARE**

**Ана Николоска**